



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT**

Seksioni për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Fëmijëve

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot.
Nr. Dok. 201800010/4

Tiranë ___/___/2018

Lënda : Rekomandim për marrjen e masave për transferimin e znj.A. P., pranë Qendrës Shëndetësore, Këlcyrë.

Drejtuar: **DREJTORISË SË SHËNDETIT PUBLIK**

**Znj. A. P.,
Qendra Shëndetësore Këlcyrë**

PËRMET

Institucioni i Avokatit të Popullit, mbështetur në pikën 1, të nenit 60, të Kushtetutës dhe ligjit nr.8454, datë 4.2.1999 "Për Avokatin e Popullit", të ndryshuar, mori në shqyrtim ankesën e shtetases A. P.,.

Në shkresën zyrtare me nr.K5/A1-2 prot., datë 23.2.2018, drejtuar Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Avokati i Popullit kërkoi informacion për trajtimin e kësaj çështje lidhur me pretendimet e ngritura nga kjo shtetase.

Në shkresën zyrtare me nr.1542/1prot. datë 8.3.2018, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale informon institucionin e Avokatit të Popullit si më poshtë vijon:

- Nga informacioni i marrë në rrugë zyrtare nga Drejtoria e Shëndetit Publik Përmet, znj.A. P., është infermiere pranë Qendrës Shëndetësore Këlcyrë, Përmet.
- Qendrat shëndetësore kanë të paktën dy deri në tre ambulanca që mbulojnë fshatrat, sipas shtrirjes gjeografike.
- Organizimi i punës dhe ndarja e detyrave është kompetencë e Drejtorisë së Shëndetit Publik, Përmet.
- Znj. Patoku nuk ka paraqitur asnjë kërkesë pranë kësaj drejtorie për transferim.

Gjithashtu, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale duke vlerësuar profilin social të znj.Patoku rekomandon trajtimin me prioritet të këtij rasti sipas legjislacionit në fuqi.

Znj. Patoku është grua e divorcuar, kryefamiljare, nëna e një fëmijë 4-vjeçar me aftësi të kufizuar dhe jeton në shtëpi me qera në Këlcyrë.

Nga vlerësimi i informacionit të lartëpërmedur dhe, në mbështetje të nenit 54, të Kushtetutës, fëmijët, të rinjtë, gratë shtatzëna dhe nënat e reja kanë të drejtën e një mbrojtje të veçantë nga shteti.

Po ashtu në mbështetje të pikës 3, të nenit 6, të ligjit nr.18/2017, “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”, interesi më i lartë i fëmijës nënkupton të drejtën e fëmijës për të pasur një zhvillim të shëndetshëm fizik, mendor, moral, shpirtëror e social, si dhe për të gëzuar një jetë familjare e sociale të përshtatshme për fëmijën, ku aftësitë e prindërve që kujdesen për mirëritjen e fëmijës t’iu përgjigjen nevojave të fëmijës, ku parim duhet të aplikohet gjerësisht në mënyrën e duhur në procedurat ligjore, administrative dhe gjyqësore.

Për sa më sipër, institucioni i Avokati të Popullit konkludoi se, gjatë marrjes së vendimit për transferimin e znj.Patoku nga Qendra Shëndetësore Këlcyrë në Qendrën Shëndetësore të njësisë administrative Maleshevë nga Drejtoria e Shëndetit Publik Përmet, nuk është marrë parasysh interesi më i lartë i fëmijës.

Në mbështetje të pikës 3, të nenit 63, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike.

Ndaj, referuar parashtrimin të mësipërm, për çështjen në fjalë,

REKOMANDIMË:

Marrjen e masave për transferimin e znj.Aleksanda Patoku nga Qendrën Shëndetësore të njësisë administrative Maleshevë në Qendra Shëndetësore Këlcyrë.

Në përputhje me nenin 22, të ligjit nr. 8454 datë 4. 2.1999 “Për Avokatin e Popullit”, të ndryshuar, organet, të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar një rekomandim, duhet ta shqyrtojnë rekomandimin dhe të kthejnë përgjigje brenda 30 ditësh nga data e dërgimit të rekomandimit.

Për sa më sipër, lutemi shqyrtimin e këtij rekomandimi dhe në vijim të na informoni për qëndrimin tuaj ndaj tij.

Duke Ju falënderuar dhe në vijim të bashkëpunimit ndërmjet institucioneve tona, në funksion të përmbushjes së detyrimeve kushtetuese dhe ligjore, për garantimin me efektivitet të ushtrimit, respektimit dhe mbrojtjes së të drejtave të fëmijës, shpresoj dhe besoj në gjykimin Tuaj për vlerësimin e këtij rekomandimi.

K O M I S I O N E R

Nejla PEKA